



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr. 2204 Regj
Nr. 580 Prot

Tiranë, më 08.03.2024

URDHËR
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓
Adresa: Tirane
Per dijene: BERALB sha me Nipt K12107002A
Adresa: Fushe-Arrez, Puke, Shkoder
Per dijene: Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore Shkoder, Rajoni V
Adresa: Shkoder

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.79 (513), date 15.06.2023 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2205, Datë 21.02.2024 kërkesën e kreditorit Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore Shkoder, Rajoni V ndaj debitorit “BERALB sha me Nipt K12107002A, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendim Perfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-SH-2022-000479-5 date 24.10.2022...”

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 461 Prot, Datë 20.02.2024, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr.79 (513), date 15.06.2023 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

BERALB sha me Nipt K12107002A, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit BERALB sha me Nipt K12107002A në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 36 pika (e), 37 pikat (c) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore **BERALB sha me Nipt K12107002A me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.**
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqesor brenda 5 ditëve nga marja dijene.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR

ERIS SOTIRI

